

VENDIM
Nr. 336, datë 31.5.2023

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS, NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE *BAYKAR MAKINA SAN. VE. TIC. A.Ş.*,
PËR FURNIZIMIN ME SISTEM MJETESH AJRORE PA PILOT *BAYRAKTAR TB2***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikave 1, shkronjat “dh” e “i”, dhe 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, dhe të pikës 2, të nenit 12, të vendimit nr. 1085, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe *BAYKAR MAKINA SAN. VE. TIC. A.Ş.*, për furnizimin me sistem mjetesh ajrore pa pilot *BAYRAKTAR TB2*, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku